



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 147/7 Prot.

Tiranë, më 27/06/2018

V E N D I M

Nr.61, Datë 27/06/2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE FIER “MBI
PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”
për periudhën nga data 01.07.2016 deri më datën 31.12.2017**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në faktin se, në dinamikën e veprimeve të përditshme ka mospërputhje në procedura, të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e Degës së Doganës Fier dhe në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare” të ushtruar në Degën Doganore Fier, sipas programit të auditimit nr. 147/1 prot, datë 12.02.2018, ndryshuar me shkresën nr. 147/2 prot, datë 26.03.2018, për veprimtarinë nga data 01.07.2016 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratojë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkojë marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura rezulton se, të ardhurat doganore nga 12,055,986 mijë lekë të programuara për periudhën e audituar janë realizuar në vlerë 11,667,827 mijë lekë, **me mosrealizim në vlerë 388,159 mijë lekë**, ose ato janë realizuar në masën **96.7%**, ku sipas zërave paraqiten: të ardhurat nga TVSH-ja nga 1,839,700 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 1,160,150 mijë lekë, duke zënë 56,8 % të të ardhurave gjithsej; të ardhurat nga Akciza nga 557,000 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 787,923 mijë lekë duke zënë 38.6% të të ardhurave gjithsej; të ardhurat nga taksa doganore nga 123,500 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 82,602 mijë lekë, duke zënë 4% të të ardhurave gjithsej; të ardhura të tjera nga 27,300 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 11,805 mijë lekë, duke zënë 0.6% të të ardhurave gjithsej. Arsyet e mosrealizimit të të ardhurave kanë qenë rënia e qarkullimit të mallrave që janë paraqitur pranë Degës Doganës Fier për kryerjen e procedurave doganore, niveli i ulët i çdoganimeve të Shoqërisë B P, mosfunksionimi i K Ballsh, T Fier, ndërprerja e aktivitetit të operatorëve ekonomikë në fushën e hidrokarbureve, rënia e theksuar e çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, ndërprerja e prodhimit të naftës për konsum nga Kompania I. Këto faktorë ekonomikë nuk janë reflektuar në programimin e planifikimit vjetor nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për Degën e Doganës Fier.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 11-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi. Dega e Doganës Fier të rrisë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për studimin, hartimin dhe programimin e objektivave realë të pranueshëm nga kjo degë doganore, zbatimin me korrektësi të legjislacionit doganor, të hartojë programe bazuar në analizë të faktorëve dhe mjedisit ekonomik, duke evidentuar risqet në fusha të caktuara të aktivitetit dhe kapacitetet e pashfrytëzuara në zëra të tjerë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor të ushtruar në Degën Doganore Fier në fund të vitit 2017 rezultojnë gjithsej 322 raste me vlerë borxhi në shumën totale **11,148,575 mijë lekë**, nga e cila detyrimi doganor në vlerë 2,988,805 mijë lekë ose 27% të të gjithë borxhit, penalitete në vlerë 7,612,000 mijë lekë ose 68% të të gjithë borxhit gjendje, kamatëvonesa në vlerë 560,937 mijë lekë ose 5% të të gjithë borxhit. Në krahasim me periudhën 30.06.2016 është rritur me 43 subjekte debitorë dhe është shtuar në vlerë 1,447,436,727 lekë. Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet shumë i ulët, si në shumën e arkëtuar edhe në numrin e rasteve mbi të cilat evidentohet veprimi i strukturave të kësaj drejtorie. Nga auditimi u konstatua se për debitorët nuk janë vendosur masat shtrënguese "Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë", nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 245 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me nr. 102/2014, datë 31.07.2014, si dhe Udhëzimit nr. 4 datë 04.08.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 11569/2 prot, datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave "Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 64 –73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi . Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Fier, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete ligjore, për rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 11,148,575 mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që

rezultojnë në gjendje debitorë, bazuar në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me kontrollet e ushtruara nga Sektori i Pajisjeve Matëse dhe Linjave Teknologjike të Departamentit të Akcizës pranë DPD, në ambientet e subjektit “Alb-Petrol” SH.A të autorizuar nga DPD, për administrimin e Magazinave Fiskale të prodhimit dhe stokimit të produkteve energjetike rezulton se, fluidet që nxirren nga nëntoka, nuk janë pjesë e Magazinës Fiskale; prodhimi i naftës nuk është pjesë e Magazinës Fiskale; linja e tubacioneve nuk kishte ndarje të qartë me magazinat fiskale të subjekteve “T” dhe “T A”; në Magazinat Fiskale nuk ka të vendosur kalimatësa për matjen e produktit të akcizës; skemat teknologjike nuk përputheshin me gjendjen reale në magazinë dhe se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për matjen e kapacitetit të depozitave (kalibrimet) të produktit për shitje, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 19; nenit 2, pika 10; nenit 20, pika 3, germa “ç”, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe jo në përputhje me kërkesat e nenit 98, pika 1 dhe pika 3 të VKM të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit ‘Për Akcizat’”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 85-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1- Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në vijim të shkresës nr. 2921 prot, datë 12.07.2016 “Kërkesë për revokimin e autorizimit të Operatorit Ekonomik “ALB-PETROL” SHA” të Degës së Doganës Fier drejtuar Departamentit të Akcizës, për mos përmbushjen e detyrimeve të lëna nga subjekti, referuar kërkesave të nenit 20, pika 4, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të revokojë autorizimin e Magazinës Fiskale të subjektit “Alb-Petrol” SH.A, nëse nuk përmbush kërkesat sipas Degës së Doganës Fier.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se nuk është zbatuar plotësisht rekomandimi nr. 1 në lidhje me “Masa për shpërblim dëmi”, konkretisht për rekomandimet B.1. për 10 punonjës në vlerë 1,749 mijë lekë dhe B.2.4, për 4 subjekte në vlerë 1,106 mijë lekë, të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm. Rezulton se Dega e Doganës Fier nuk ka dalë me vendime administrative në total për vlerën **2,855 mijë lekë**

(Më hollësisht trajtuar pikën 1, faqet nr 7-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH për shpërblim dëmi, në vlerën **2,855 mijë lekë** për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar me shkresën nr. 853/6 prot, datë 30.12.2016.

Menjëherë

Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore ku rezultojnë të përfshira rekomandime të trajtuara sa më sipër që lidhen me këtë pikë “Masa organizative”, trajtuar në faqet 7 deri 14, faqet 64 deri 73 dhe faqet 85 deri 8, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ana e Degës Doganore

Fier të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht edhe KLSH-në, në lidhje me afatet dhe ecurinë e procesit gjyqësor në vijimësi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI(të ardhura të munguara)

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Fier të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i të ardhurave të munguara në **Buxhetin e Shtetit në shumën 504,224 mijë lekë, të paraqitura** në mënyrë analitike nga pika 3, 4, 6 dhe 7, sipas anekseve 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4 dhe 7, si dhe në faqet nr. 14-64 dhe 73-87 si më poshtë:

1.- Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikave doganore IM4 dhe procedurave të ndjekura lidhur me deklarimin e mallrave, rezultuan raste të: shqyrtimit jo si duhet të vlerës doganore të mallrave dhe shpenzimeve të transportit; trajtimit me origjinë preferenciale të artikujve me deklarata faturë, nga sektori operacional, vlera e të cilëve e kalon 6000 euro; si dhe keqklasifikim i kodit tarifor të artikujve me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 1, germa "I" Titulli I, nenit 22 dhe nenit 26, Titulli V, të Udhërrëfyesit të MSABE "Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë"; nenit 34-37, nenit 256.2, nenit 256.4, nenit 261.1, nenit 261.2 dhe nenit 261.3 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 67-70 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"; Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, të Ministrit të Financave "Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore", nxjerrë për këtë qëllim si dhe Udhëzimit nr. 5883 prot., datë 16.05.2006, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD "Dokumenti i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 14-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

1.1- Rekomandimi: Dega e Doganës Fier të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore dhe penalteteve **për 1601 raste, në vlerën 276,970 mijë lekë**, nga subjektet sipas anekseve nr. 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datën 30.09.2018

2.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave mbi veprimtarinë e operatorëve ekonomik që operojnë në fushën e regjimeve të përpunimit aktiv u konstatua se nga ana e nëpunësve të sektorit të regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për: shkeljet doganore lidhur me shkeljet nga ana e subjekteve të afateve për mbylljen e regjimeve; dhënien e origjinës preferenciale të mallrave të trupëzuara në produkte kompensuese; për diferencat në riekporto të produkteve kompensuese referuar koeficientit të shfrytëzimit, si dhe dokumenti i mbylljes së regjimit në asnjë rast nuk është miratuar nga kryetari i degës së doganës, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 272 pika 2; 275 pika 1; 261, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 256, pika 1, germa "b" të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15, pika 2; nenit 6, pika 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 të D.P.D "Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Fier të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore dhe penalteteve për **23 raste/subjekte, në vlerën 1,013 mijë lekë**. nga subjektet sipas aneksit nr. 4, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datën 30.09.2018

3.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave mbi veprimtarinë e operatorëve ekonomik që kanë kryer veprimtari në zbatim të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, të pajisur me Magazinë Fiskale për prodhimin e produkteve energjetike rezultuan: procesverbal i mbajtur për kontrollin dhe inventarizimin e mallrave të akcizës në kushtet e revokimit të autorizimit, pa përlllogaritur detyrimet e akcizës; procesverbal i mbajtur për shkelje në fushën e akcizës pa kryer përlllogaritjen e detyrimeve të akcizës të pa paguara, si dhe mosplotësim nga ana e subjekteve të detyrave të lëna lidhur me eliminimin e mangësive dhe problematikave të konstatuara nga kontrollet e ushtruara, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 1, pika 3, germa “c” dhe “d”; neni 18, pika 2; neni 97, pika 3; neni 103, pika 1, germa “a” dhe “b”; neni 97, pika pika 3; neni 96/1, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe neni 15, pika 1, germa “d” të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “*Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit ‘Për Akcizat’*”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 83-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Fier të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore të akcizës dhe penalteteve për **2 raste/subjekte, “D OA” dhe “Alb-Petrol”**, të pajisur me Magazinë Fiskale për prodhimin e produkteve energjetike, në vlerën **196,973 mijë lekë**, nga subjektet sipas anekseve nr. 7, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më datën 30.09.2018

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 250, 256, 258 dhe 275, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, ndryshuar me nr. 102/2014, datë 31.07.2014, jo në përputhje me nenet 85, 90, 91, 94 dhe 95 të ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012, “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. Nga mosveprimi në përputhje me kërkesat e neneve të mësipërme ka lindur një efekt financiar me të ardhura të munguara në *Buxhetin e Shtetit në shumën 13,898 mijë lekë* për 10 raste subjektësh për vendime të nxjerra gjatë periudhës 01.07.2016 deri 31.12.2017.

(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 73-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi. Dega Doganore Fier të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale **13,898 mijë lekë për 10 raste** subjektësh duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore nga 10 operatorë tregtare bazuar në ligjin nr. 8449, datë 20.01.1999, “*Kodi Doganor në Republikën e*

Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 61, datë 24.05.2012, “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Deri më datën 30.09.2018

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave mbi veprimtarinë e operatorëve ekonomik që kanë kryer veprimtari në zbatim të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, rezultuan Dokumente Shoqërues Administrativ me detyrime të akcizës të papaguara si dhe procesverbal i mbajtur pa përlllogaritur detyrimet e akcizës, veprime këto, jo në përputhje të kërkesave të nenit 4, pika 1 dhe 3; nenit 85, pika 2 dhe nenit 103, pika1, pika 2, germa “a”, “b” të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Për sa më sipër Autoriteti Doganor ka dalë me vendimin administrativ nr. 40, datë 19.03.2018 për vlerën **15,367 mijë lekë**. (*Më hollësisht trajtuar në faqen nr. 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi. Dega e Doganës Fier të marrë masa për vjeljen e borxhit doganor të akcizës, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e dëmit për **1 rast**, në vlerën **15,367 mijë lekë** nga subjekti “**T**” referuar nenit 103, pika1, pika 2, germa “a”, “b” të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Në vijimësi

Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore ku rezultojnë të përfshira rekomandime të trajtuara sa më sipër që lidhen me këtë pikë “Masa për shpërblim dëmi”, trajtuar në mënyrë analitike nga pika 3, 4, 6 dhe 7, sipas anekseve 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4 dhe 7, si dhe në faqet nr. 14-64 dhe 73-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ana e Degës Doganore Fier të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht edhe KLSH-në, në lidhje me afatet dhe ecurinë e procesit gjyqësor në vijimësi.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Kryetarit të Degës Doganore Fier dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të shkeljeve, sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për 9 (nëntë) personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013.

D. TË TJERA

Nga auditimi i ushtruar në Degën Doganorë Fier, rezultoi se, për Depozituesit e Miratuar të pajisur me autorizim për Magazinë Fiskale për prodhimin e produkteve energjetike, procesi i prodhimit nga nëntoka, deri në dekantimin final, si dhe hedhja e holluesit, kryhet jashtë ambienteve të aprovuara të Magazinës Fiskale dhe rrjedhimisht jo nën mbikëqyrje doganore, duke rritur mundësinë e evazionit fiskal. Këto dukuri janë në kundërshtim me Ligjin nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”.

Për sa më sipër, në një afat të përshtatshëm, KLSH do të zhvillojë auditim tematik për procesin e miratimit të autorizimit për hapjen dhe shfrytëzimin e një Magazine Fiskale për Depozituesit e Miratuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R